



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 259, Datë 28.12.2020

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “AGETA” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “BORIE – LURË 1” ME KAPACITET TË INSTALUAR 1800 KW.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “a”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1 gërma “a”, nenit 10, pika 3 dhe nenit 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 142/1 Prot, datë 24.12.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “AGETA” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “AGETA” sh.p.k., me shkresën nr. 8 prot, datë 17.12.2020 dhe protokolluar në ERE me nr. 1288 Prot, datë 21.12.2020, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Borie Lurë 1”, me vendodhje në ujërat e përrenjëve të kurorës së Lurës, degë e Lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër.
- Shoqëria “AGETA” sh.p.k., është regjistruar pranë QKB-së në datën 17.12.2014, konform Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Rregjistrimit” me statusin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar.
- Nga analiza e dokumentacionit në fazën e fillimit të procedurave të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë “AGETA” sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson

kryesisht kërkesat e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim, Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”, **plotësuar.**
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “f”, **plotësuar;**
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal., Neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “d” **plotësuar;**
  - Dokumentacioni teknik për HEC, Neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”, dhe pika 4.1.4, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”, **plotësuar.**
  - - Leje nga institucione të tjera. Neni 9, pika 4.1.5, gërmat “a”, “b”, **plotësuar.**
- Në përfundim të afatit të Lejes së përdorimit të burimit ujor (datë 09.04.2022), do ti kërkohej shoqërisë ta depozitojë në ERE të rifreskuar, një muaj pas rinovimit të afatit të saj.
  - Duke qenë se Urdhri mbi vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor kullor, është dokument i cili lidhet me pronësinë shoqëria pasi të pajiset me miratimin final për heqjen nga fondi pyjor kullor publik të sipërfaqjes së përcaktuar më sipër, ta depozitojë atë në ERE.
  - Kontrata nr. 65 REP., nr. 38/1 KOL., datë 16.01.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Borie Lurë 1”, me kapacitet prodhues 1800 kW, në rrjedhën e përrenjve të kurorës së Lurës, degë e lumit Drin i Zi, Bashkia Dibër, Qarku Diber”, e lidhur midis MIE dhe Mbajtësit të Miratimit, Bashkimit të përkohshëm të shoqërive “AGETA” sh.p.k. dhe “Bajrami N” sh.p.k, ka një afat 49- vjecar, por nga ana tjetër shpjegojmë se ERE në zbatim të nenit 38, të Ligjit “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 5, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2:

- gërma “e” (Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse. Në rastin e aplikimeve për licencë prodhimi të energjisë elektrike kërkohej paraqitja e licencës për drejtues teknik elektrik.
- gërma “g” (dokumenta që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (kontrata shit-blerje, kontrata qiraje, akte dhurimi, kontrata

premtim shitblerje, marrëveshje me subjektet që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti);

Dokumentacioni financiar dhe fiskal, Neni 9, pika 3:

- gërma “c” (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qarte vlerat monetare për financim dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacion, të tjera, etj),

Leje nga institucione të tjera, Neni 9, pika 4.1.5.

- gërma c. Leja Mjedisore,

do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “AGETA” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Boria Lura 1”; me kapacitet të instaluar 1800 kW, për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**